



# USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 31 (827835)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 gusht 2023

## Zhvillohet analiza 6 - mujore e punës dhe aktiviteteve të Forcave të Armatosura të RSH

Në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm, u zhvillua analiza 6 - mujore e punës dhe aktiviteteve të Shtabit të Përgjithshëm, forcave dhe njësive vartëse, nën drejtimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji dhe me pjesëmarrjen e zëvendëshefit të SHPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantët e forcave, drejtorët e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm dhe komandantët e njësive autonome. Analiza 6 - mujore u fokusua në diskutimin

rreth arritjeve të deritanishme të orientuara nga vizioni i SHSHPFA për vitin 2022 - 2025 mbi: implementimin e ndryshimeve strukturore, hartimin dhe rishikimin e akteve ligjore/VKM për FARSH, menaxhimin e personelit, sigurinë, gatishmërinë, angazhimet në stërvitje dhe misione brenda dhe jashtë vendit, mbështetjen logjistike, përmirësimin e infrastrukturës stërvitore, planifikimin dhe monitorimin e mbrojtjes, mbështetjen shëndetësore, sigurinë kibernetike, si dhe angazhimet dhe

prioritetet kryesore për në vijim. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji në fjalën e tij falënderoi çdo komandant njësie dhe drejtues për punën dhe përpjekjet e tyre për realizimin e detyrave gjatë këtij 6-mujori: "Është momenti të bëjmë një vlerësim të realizimeve më kryesore të kësaj periudhe dhe të diskutojmë mbi detyrat dhe objektivat që i kam vlerësuar të domosdoshme për përqendrimin e punës dhe aktiviteteve të FARSH..." >>> faqe 2



Kontingjenti i dytë b3k me mision në Novo Selo, Bullgari, mori pjesë në stërvitjen "Platinum Lion - 23"

## Përmirësimi i aftësive operationale në kryerjen e veprimeve të përbashkëta luftarake në mjedis shumëkombësh, synim i FA



>>> faqe 3

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji vizitoi anijen TCG "Bayraktar"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji vizitoi anijen TCG "Bayraktar" e ankoruar në portin e Durrësit, me ftesë të Ambasadorit të Republikës Turke Sh.T.z. Tayyar Kagan Atay dhe komandës drejtuese të anijes. Ekuipazhi i anijes përbëhet nga studentë të Akademisë Detare të cilët po zhvillojnë stazhin e tyre duke lundruar në vende të ndryshme, ku pjesë e së cilës është dhe një student shqiptar që së shpejti...



>>> Faqe 2

Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit të Dytë EOD, niveli III

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Dytë EOD, niveli III. Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben Dhuli. Kursi i Dytë EOD, niveli III u zhvillua nga data 12 qershor 2023 deri më 28 korrik 2023 dhe përfundoi sot me certifikimin e 9 specialistëve EOD. Objektivi i kursit është aftësimi i operatorëve EOD në zhvillimin e procedurave të vënies...



>>> Faqe 4

Qëndrueshmëria e infrastrukturës kritike në kontekstin e pasigurisë kibernetike të shkaktuar nga kërcënimet hibride

Në ditët e sotme, pasi aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë kanë zhvilluar metoda të reja hibride për të promovuar interesat e tyre, koncepti i mbrojtjes së infrastrukturës kritike ka fituar vlerë të re nga perspektiva e qëndrueshmërisë dhe sot, shumica e incidenteve të sigurisë ndodhin në hapësirën kibernetike. Ky shkrim merr në konsideratë dhe shqyrton ndërlidhjen midis koncepteve të "luftës hibride - infrastrukturës kritike - sulmeve kibernetike", nisur nga kushtet e vendit tonë, sidomos të Forcave të Armatosura. Prandaj, ne fillojmë me supozimin se hapësira kibernetike është mjedisi...



>>> Faqe 5



# Zhvillohet analiza 6 - mujore e punës dhe aktiviteteteve të Forcave të Armatosura të RSH

Në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm, u zhvillua analiza 6 - mujore e punës dhe aktiviteteteve të Shtabit të Përgjithshëm, forcave dhe njësive vartëse, nën drejtimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji dhe me pjesëmarrjen e zëvendëshefit të SHSHPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantët e forcave, drejtorët e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm dhe komandantët e njësive autonome.

Analiza 6 - mujore u fokusua në diskutimin rreth arritjeve të deritanishme të orientuara nga vizioni i SHSHPFA për vitin 2022 - 2025 mbi: implementimin e ndryshimeve strukturore, hartimin dhe rishikimin e akteve ligjore/VKM për FARSH, menaxhimin e personelit, sigurinë, gatishmërinë, angazhimet në stërvitje dhe misione brenda dhe jashtë vendit, mbështetjen logjistike, përmirësimin e infrastrukturës stërvitore, planifikimin dhe monitorimin e mbrojtjes, mbështetjen shëndetësore, sigurinë kibernetike, si dhe angazhimet dhe prioritetet kryesore për në vijim.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji në fjalën e tij falënderoi çdo komandant njësie dhe drejtues për punën dhe përpjekjet e tyre për realizimin e detyrave gjatë këtij 6-mujori: “Është momenti të bëjmë një vlerësim të realizimeve më kryesore të kësaj periudhe dhe të diskutojmë mbi detyrat dhe objektivat që i kam vlerësuar të domosdoshme për përqendrimin e punës dhe aktivitetit të FARSH në vijim...”, - u shpreh shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji vizitoi anijen TCG “Bayraktar” e ankoruar në portin e Durrësit, me ftesë të Ambasadorit të Republikës Turke Sh.T. z. Tayyar Kağan Atay dhe komandës drejtuese të anijes. Ekuipazhi i anijes përbëhet nga studentë të Akademisë Detare të cilët po zhvillojnë stazhin e tyre duke lundruar në vende të ndryshme, ku pjesë e së cilës është dhe një student shqiptar që së shpejti do t'i bashkohet FA-së. Turqia është një nga bashkëpunëtorët kryesorë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke i dhënë një mbështetje të rëndësishme Forcave të Armatosura në logjistikë, trajnim, stërvitje, edukim ushtarak, si dhe përgjatë emergjencave civile në Shqipëri.



Mbi 2700 vizita dhe konsulta mjekësore janë bërë nga personeli mjekësor i FT-së në qytetet: Tiranë, Shkodër dhe Berat, në kuadër të mbështetjes shëndetësore dhe ofrimit të ndihmës së parë mjekësore ndaj popullsisë civile, për përballimin e situatës së temperaturave të larta.



STAFI

**ANJEZA MUSOLLARI**  
Shefe e Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:  
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:  
Suela **HODA**

Graphic Designer:  
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”



Kontingjenti i dytë b3k me mision në Novo Selo, Bullgari, mori pjesë në stërvitjen e përbashkët shumëkombëshe “Platinum Lion - 23” me temë “Kompania e Mekanizuar në mbrojtje në Eskalionin e parë të batalionit”, e cila synonte përmirësimin e aftësive operacionale në kryerjen e veprimeve të përbashkëta luftarake në një mjedis shumëkombësh. Shtetet pjesëmarrëse në këtë stërvitje ishin Shqipëria, Bullgaria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

Toga shqiptare e batalionit të tretë të këmbësorisë, tregoi profesionalizëm në të gjitha veprimet në fushëbetejë dhe një bashkëpunim të shkëlqyer me trupat e kombeve të tjera pjesëmarrëse.



Kontingjenti i dytë b3k me mision në Novo Selo, Bullgari, mori pjesë në stërvitjen “Platinum Lion - 23”

# Përmirësimi i aftësive operacionale në kryerjen e veprimeve të përbashkëta luftarake në mjedis shumëkombësh, synim i FA



Në vijimësi të përgatitjes së ekipit që do të përfaqësojë Forcën Tokësore në stërvitjen “Cambrian Patrol”, e cila do të zhvillohet në Wells, Mbretëria e Bashkuar, është zhvilluar me sukses stërvitja 72-orëshe në rajonin e Mnelës dhe stërvitja “Kalim i pengesave ujore” në rajonin e Bovillës. Gjatë trajnimit, efektivët e FT-së treguan devotshmëri dhe përkushtim të lartë në realizimin e objektivave të tyre.



## IN MEMORIAM

*Ndahet nga jeta N/Kolonel Dritan Muka. Vdekja e parakohshme e ndau nga familja, fëmijët, miqtë, shokët, kolegët e Forcave të Armatosura, ku shërbeu me përkushtim dhe devotshmëri. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji si dhe miq dhe kolegë të tij do të shprehin ngushëllimet e tyre të sinqerta për N/Kolonel Dritan Muka.*



*Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Të pikëlluar për ndarjen e parakohshme nga jeta të N/Kolonel Dritan Mukës. Ngushëllime familjarëve dhe kolegëve për humbjen e të dashurit, mikut dhe ushtarakut të devotshëm e të përkushtuar! Ngushëllime të sinqerta familjes për këtë humbje shumë të madhe për të! Shpirti i Tij u prehtë në paqe!*





# Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit të Dytë EOD, niveli III

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Dytë EOD, niveli III.

Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben Dhuli.

Kursi i Dytë EOD, niveli III u zhvillua nga data 12 qershor 2023 deri më 28 korrik 2023 dhe përfundoi sot me certifikimin e 9 specialistëve EOD.

Objekti i kursit është aftësimi i operatorëve EOD në zhvillimin e procedurave të vënies në Siguresë, si dhe asgjësimi përfundimtar deri në 50 kg NEQ të muni-



cioneve eksplozive.

Zhvillimi e mbarëvajtja e këtij kursi u mbikëqyr nga kompania "Golden West" dhe përfaqësues të Forcës Ajrore USA. Shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Dhuli pasi falënderoi palën amerikane për mbështetjen, përgëzoi kursantët për përfundimin me sukses të këtij kursi duke shtuar se: "Përfundimi i këtij kursi ju çon në një nivel të lartë të përgatitjes suaj profesionale gjë që ju krijon mundësinë e realizimit të operacioneve EOD në shkallë më të lartë vështirësie."

Në fund u shpërndanë certifikatat e përfundimit të kursit.

Gjatë muajit qershor dhe korrik 2023, Detashmenti i Urave i Batalionit të Xhenios në Komandën Mbështetëse ka realizuar ndërtimin e katër urave metalike tip "Bailey" në qarkun e Korçës, duke bërë që banorët e fshatrave Voskopojë, Voskop, Mborje dhe Melçan të lidheshin me fshatrat e tjerë të zonës.

Me 10 forca dhe 6 mjete, ata ndërtuan në katër fshatrat 54 m urë, ku secila nga ato ka një peshëmbajtje deri 40 ton.

Ndërtimi i këtyre urave bëri të mundur lidhjen e lagjeve në fshatin Melçan. Në Voskopojë ura me gjatësi 18 m, mundësoi lidhjen e zonës së bujtinave me pjesën tjetër të fshatit. Në fshatin Mborje u lidhën dy fshatra, duke mundësuar dhe kalimin e mjeteve. Ura me gjatësi 15 m e ndërtuar në fshatin Voskop që në ditët e para të vënies në shfrytëzim mundësoi kalimin e banorëve të zonës me mjetet dhe bagëtitë e tyre për në kullotat dhe tokën bujqësore të zonës. Ura e ndërtuar në fshatin Karroq, bashkia Finiq ka një gjatësi 24 m, seksion 2/1 dhe peshëmbajtje deri 24 ton. Për këtë urë u angazhuan 10 forca dhe 3 mjete. Kjo urë shërben për lidhjen e fshatrave Karroq, Zminec, Grazhdan me doganën e Ripsit, duke mundësuar lëvizjen e 1500 banorëve.

## Batalioni i Xhenios ndërton katër ura në qarkun e Korçës dhe një urë në Finiq







N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

# Qëndrueshmëria e infrastrukturës kritike në kontekstin e pasigurisë kibernetike të shkaktuar nga kërcënimet hibride

## NJË VËSHTRIM RRETH SIGURISË SË INFRASTRUKTURËS - NË KUADRIN E KONFERENCËS SHKENCORE PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Në ditët e sotme, pasi aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë kanë zhvilluar metoda të reja hibride për të promovuar interesat e tyre, koncepti i mbrojtjes së infrastrukturës kritike ka fituar vlerë të re nga perspektiva e qëndrueshmërisë dhe sot, shumica e incidenteve të sigurisë ndodhin në hapësirën kibernetike.

Ky shkrim merr në konsideratë dhe shqyrton ndërlidhjen midis koncepteve të "luftës hibride - infrastrukturës kritike - sulmeve kibernetike", nisur nga kushtet e vendit tonë, sidomos të Forcave të Armatosura. Prandaj, ne fillojmë me supozimin se hapësira kibernetike është mjedisi më i ndjeshëm ndaj dobësive dhe sulmeve të mundshme, duke ndikuar më pas në shërbimet jetike edhe për njerëzit. Prandaj, në këtë kontekst theksojmë se kërkimi ynë përqipet të adresojë pyetjen e mëposhtme: Brenda sferës së kërcënimeve hibride, a mund të gjenerojnë dobësi në hapësirën kibernetike dhe në dhënien e efekteve të nivelit strategjik në infrastrukturatur kritike? Për ta arritur këtë, ne kemi përdorur mjete të arsyeshme për të identifikuar punimet shkencore që eksplorojnë mosdhëniet midis "luftës hibride - infrastrukturës kritike - sulmet kibernetike".

Më pas, jemi përpjekur të zgjerojmë analizën tonë për të përfshirë shkrimet, studimet dhe artikujt të fokusuar në studimin e më shumë ngjarjeve edhe të një koncepti të vetëm midis atyre të përmendur në këto botime.

Rezultatet e analizës sonë tregojnë se dobësitë e shfrytëzuara brenda një rrjeti Wi-Fi ose një panel kontrolli industrial të një infrastrukture kritike në hapësirën kibernetike mund të kenë pasojë të gjera që mund të ndikojnë në shërbimet jetike të kërkuara, duke rezultuar në një ndërprerje të përkohshme, siç ka ndodhur në vendin tonë në tremujorin e parë të vitit 2023 të cilat synuan fshirjen elektronike të shtetit për shërbimet themelore të tij. Një sulm i tillë, që buron nga përpjekjet minimale për sa i përket kohës, personelit dhe burimeve financiare, mund të çojë në dëme të konsiderueshme pronësore.

Mënyra në të cilën ka evoluar lloji i ri i luftës, të cilin specialistët e quajnë "luftë hibride", shpesh mund të përshkruhet më lehtë sesa të përcaktohet. Kjo, nga njëra anë, për faktin se gjërat janë në një evolucion kaq të përshpejtuar, sa që realiteti në terren shpaloset me një shpejtësi shumë më të madhe se sa mund të konceptohet dhe përcaktohet nga specialistët, dhe, nga ana tjetër, sepse metodat shtrënguese dhe subversive të përdorura nga agresori me qëllim të minimimit dhe destabilizimit të kundërshtarit ndodhin në një zonë shumë të larmishme fushash.

Nëse para disa vitesh mjaftonte të analizohej kjo lloj lufte nga këndvështrimi i fushave PMESII (politike, ushtarake, ekonomike, sociale, informative dhe infrastrukturale), më vonë ato u ndërthurën me aspektin teknologjik, legjislativ dhe mjedisor, duke krijuar një model të ri analize (politik, ekonomik, social, teknologjik, ligjor, mjedisor). Aktualisht, kombinimi i akronimeve përqipet të përfshijë kompleksitetin e paketave të sulmeve të sinkronizuara nga agresorët duke përdorur metoda hibride të luftës.

Kompleksiteti i kësaj lloji lufte të re nuk jepet vetëm nga fakti se ajo përdor metoda shtrënguese dhe subversive, por edhe se rekrutimi dhe përfshirja e drejtpërdrejtë e aktorëve zhvillon karakteristikën e saj të dykuptimisë. Një shembull janë ndodhitë në RSH, ku sulmuesit kibernetikë përfaqësohen nga grupet kriminale që operojnë në mjedisin kibernetik dhe shfrytëzojnë dobësitë në këtë fushë, duke kontribuar në atë që specialistët sot i quajnë "operacione kibernetike".

Revolucioni i informacionit kontribuoi në rritjen e kompleksitetit të mjedisit aktual të sigurisë, dhe informacioni u konsiderua një aspekt i rëndësishëm i projektimit të mjeteve të energjisë DIME (diplomatie, informative, ushtarake dhe ekonomike). Me zhvillimin e teknologjive të reja, Inteligjencës Artificiale (AI) dhe 5G, etj.,



informacioni ka ndryshuar gjithashtu mjedisin e tij në të cilin funksionon, duke lëvizur nga letra në kompjuter, nga zarfi në zyrë dhe nga posta e automjeteve të transportit në kompjuter të sigurt. Në këto kushte, përparim teknologjik nënkupton përmirësimin e kushteve të jetesës, por edhe epërsinë teknologjike që mund të përdoret si kalë trojan për të përfutur avantazhe në fushat politike, ushtarake, ekonomike, sociale, informative dhe infrastrukturale.

Fusha e mbrojtjes së infrastrukturës kritike trajtohet ndryshe në literaturën e specializuar. Kështu, ka qasje nga këndvështrimi i analizës së komponentëve arkitekturorë, si ato fizike dhe kibernetike, fizike dhe dixhitale ose marrëdhëniet ndërmjet këtyre, të nisura nga perspektiva e menaxhimit të rrezikut ose ndikimi i teknologjive në zhvillim në infrastrukturatur kritike.

Për operacionalizimin e pyetjes kërkimore nga e cila nisem këtë qasje shkencore, përdorim programin analitik, "punimet e mëparshme" (referencat) dhe "punimet e derivuara", punimet që citojnë artikullin origjinal të disponueshëm (Connected Paper) me synim për të identifikuar në literaturën e specializuar punimet shkencore që analizojnë marrëdhënien "infrastruktura kritike të luftës hibride - sulme kibernetike". Më vonë kemi zhvilluar deduksionin e përfutur në analizën e shtrirë në kohë në disa artikuj shkencorë që kanë si objekt studimi dy apo edhe një koncept të vetëm nga ato të paraqitura.

Dokumentet e lidhura janë një mjet për vizualizimin e lidhjeve midis artikujve shkencorë, të lidhur me dokumentet kryesore të sigurisë dhe mbrojtjes, i cili synon të ndihmojë studiuesit të gjejnë dhe eksplorojnë punime të rëndësishme për fushën e tyre të interesit. Më tej në programimin e punës kemi përfutur ecurinë në perspektivë, në të cilin artikujt janë renditur sipas ngjashmërisë së temave të trajtuara dhe grupon vizualisht punime nga fusha të ngjashme pa bërë lidhjen e citimeve midis tyre.

Pas pyetjes së parë të platformës (Connected Papers), në kërkim të artikujve shkencorë që analizojnë konceptet "luftë hibride - infrastruktura kritike - sulme kibernetike", identifikua punimet e tjera. Modeli relacional që rezultoi përmbante një artikull të vetëm shkencor që korrespondon me fushën e interesit të vëzhgimit aktual, në të cilin autori thekson konceptet kryesore të "luftës hibride" dhe "sulmit kibernetik" për të theksuar rolin e luajtur nga menaxhimi i personave dhe mjekësia për të mbrojtur infrastrukturën dixhitale kritike. Të gjithë artikujt e tjerë shkencorë të identifikuar kanë të bëjnë rreptësisht me fushën mjekësore dhe më pak me infrastrukturatur kritike, sulmet kibernetike ose kërcënimet hibride.

Më pas, analiza jonë u kufizua në konceptet "sulm kibernetik" dhe "kërcënim hibrid". Dhe në këtë situatë, shumica e artikujve mbulojnë fusha të tilla si bazat e të dhënave, analiza e të dhënave dhe mënyrat për t'i kërkuar ato.

Rezultatet e dy pyetjeve të platformës "Connected Papers" treguan se ka pak kërkime shkencore që analizojnë marrëdhëniet midis "luftës hibride - infrastrukturës kritike - sulmeve kibernetike". Prandaj, qasja jonë shkencore vazhdon të fokusohet në analizën e literaturës që trajton konceptet veçmas dhe që identifikon lidhje të caktuara shkakësore ndërmjet tyre.

Kështu, për të trajtuar çështjen e sigurisë kibernetike nga këndvështrimi i kërcënimeve hibride, ne duhet të përdorim modelin konceptual të ndërlidhjes së sistemeve të hapura (OSI) të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim dhe të bëjmë analizën e informacionit që mund të përdoret, se cilat janë dobësitë dhe roli i sigurisë kibernetike në përballimin e kërcënimeve.

Me modifikimin e mjedisit operativ dhe ndërveprimin e teknologjive të reja janë shfaqur dobësi dhe kërcënime që duhen menaxhuar nga ekspertë të sigurisë kibernetike në mënyrë që informacioni të qarkullojë më shpejt dhe të jetë më i sigurt, duke siguruar praktikisht tre të karakteristikat, si: konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria. Kështu, problemet kibernetike janë kthyer në një çështje sigurie kombëtare dhe ndërkombëtare, për faktin se roli dhe rëndësia e informacionit është rritur në mjedisin aktual. Sot, informacioni ofron mundësinë për të ndikuar në besimet, për të prodhuar ose futur ide dhe për të zhvilluar njohuri.

Siguria kibernetike përfaqëson fushën që përmban hapësirën fizike dhe virtuale, e cila trajton si problemin e pasigurisë, por edhe ato që lidhen me teknologjinë, proceset dhe procedurat, të cilat kontribuojnë në arritjen e sigurisë.

Në kontekstin e kërcënimeve hibride, "pasiguria kibernetike" dhe "sulmet informative" përfaqësojnë elementet thelbësore të mjeteve jo konvencionale të përdorura nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë, të cilët kanë një ndikim të fortë psikologjik në opinionin publik. Nga ana tjetër, dobësitë, por veçanërisht lidhjet midis infrastrukturave kritike, kanë prodhuar marrëdhënie ndërvarësie përmes të cilave një infrastrukturë kritike mund të varet nga shërbimet thelbësore të ofruara nga një infrastrukturë tjetër kritike apo edhe nga vetë infrastruktura.

Pavarësisht nga llojet e ndërvarësisë që ekzistojnë, një gjë është e përbashkët për të gjitha, dhe ajo është informacioni dhe sistemet kompjuterike.

Kjo është arsyeja pse disa studues dhe autorë të tjerë i referohen informacionit, proceseve dhe teknologjive të informacionit që përbëjnë infrastrukturën kritike të informacionit, prishja e së cilës mund të çojë në ndikimin e performancës, besueshmërisë dhe sigurisë së infrastrukturave kritike të varura prej tyre.

Në këtë kontekst, mjetet kryesore të përdorura nga sulmuesit janë malware (ai softuer me qëllim të keq) dhe sulmet e mohimit të shërbimit të shpërndarë të afta për të vonuar, prishur, korruptuar, shfrytëzuar, shkatërruar, shmangur ose modifikuar informacionin e përdorur në kibernetikën hapësinore. Një zgjidhje e mundshme do të ishte përdorimi i teknologjive të informatikës në mbrojtjen e infrastrukturave kritike, të cilat do të siguronin tepriç të sistemit dhe do të siguronin akses të përhershëm në të dhëna. Në këtë situatë, sistemet që kryejnë kontrollin e mbikëqyrjes dhe marrjen e të dhënave në rastin e proceseve industriale mund të preken pas një sulmi, nëse nuk ka asnjë sistem tjetër për të përdorur infrastrukturën për kërkimin dhe transmetimin e informacionit thelbësor për funksionimin e sistemit.

Megjithatë, faktori njerëzor mbetet elementi thelbësor në procesin e qëndrueshmërisë të infrastrukturave kritike, megjithëse evolucionin teknologjik po merr më shumë rëndësi. Kështu, duke marrë parasysh këtë evolucion teknologjik dhe kompleksitetin e ngjarjeve në mjedisin e sigurisë, krizat aktuale mund të shmangen, reduktohen në ndikim ose zgjidhen nëpërmjet një qëndrimi proaktiv të faktorëve njerëzorë dhe përmes zhvillimit të politikave solide dhe strategjive të aktorëve shtetërorë.

Analiza e sulmeve hibride në infrastrukturatur kritike ka nxjerrë në pah faktin se shumica e tyre ndodhin në hapësirën kibernetike, pasi ato janë më pak të kushtueshme se llojet e tjera të sulmeve, përfshijnë një numër të reduktuar personeli, kosto më të ulëta dhe ekspozim të reduktuar të sulmuesve. Kështu, një sulm i thjeshtë mbi elementet përbërës të paraqitur në modelin konceptual të ndërlidhjes së sistemeve të hapura mund të prodhojë efekte të nivelit strategjik në infrastrukturën kritike të sulmuar. Me fjalë të tjera, një sulm në një rrjet të thjeshtë wireless, një kalkulator ose një panel kontrolli industrial të një infrastrukture kritike mund të ketë pasojë të mëdha mbi to dhe mund të çojë në mungesën e ofrimit të shërbimeve thelbësore për popullatën, si uji i pijshëm, energjia elektrike, gaz natyror etj. Për më tepër, duke analizuar konceptin e luftës hibride dhe kërcënimit hibrid, zbuluam se sulmet kibernetike janë një mjet i përdorur nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë, në kontekstin e përdorimit të teknikave dhe taktikave hibride të luftës për një potencial. Në këto kushte, një mënyrë efektive për të zhvilluar qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike për të luftuar sulmet kibernetike mund të arrihet me ndihmën e qendrave të sigurisë në domenin kibernetik.

Sot nuk ka pothuajse asnjë punonjës të infrastrukturës kritike që nuk operon me kompjuterë apo pajisje të ndryshme elektronike. Në këtë kontekst, me zbatimin e dixhitalizimit brenda shoqërisë, çdo person është shndërruar në një sensor dhe në të njëjtën kohë, një hallkë e ndjeshme potenciale në procesin e mbrojtjes së infrastrukturave kritike. Kështu, për të reduktuar dobësitë në hapësirën kibernetike, është e nevojshme të krijohet një kulturë sigurie në nivelin e çdo qytetari, një kulturë që kontribuon në rritjen e elasticitetit të infrastrukturave kritike. Kjo dëshirë mund të arrihet përmes zhvillimit të programeve arsimore, duke filluar me programet e studimit të nivelit të shkollës së mesme dhe duke vazhduar me programet Bachelor dhe Master, të cilat krijojnë aftësi profesionale dhe shpjegojnë lidhjet shkakësore midis dobësive në hapësirën kibernetike.

Në të ardhmen e afërt, me zhvillimin e inteligjencës artificiale dhe teknologjive të reja sulmuese, sulmet në hapësirën kibernetike do të rriten si në intensitet ashtu edhe në numër. Në këtë normalitet të ri, fusha e sigurisë kibernetike do të ketë një rol veçanërisht të rëndësishëm në mbrojtjen e infrastrukturave kritike për të siguruar shërbime thelbësore për popullatën, sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.





ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

# “Një ditë takova një fëmijë të verbër. Më kërkoi t’i përshkruaja detin, unë duke e parë ia përshkrova. Pastaj më kërkoi t’i përshkruaja botën, dhe unë duke qarë e gënjeva”

**A**skush nuk do ta kuptonte këtë jetë nëse nuk do të përballlej para saj me realitetin e së vërtetës.

E ndërsa bëjmë moral, nga mëngjesi në darkë, nga ana tjetër, rendim si individë me ndërgjegje të frustruar, duke i rrahur krahët imoralitetit dhe intrigantit, si të frikur e pa identitet.

Sot po jetojmë mes shumë padrejtësive, mes imoralitetit, mes padijes, mes heronjve shterpë, e heroinave të stilit trojan, mes gënjeshtërës, mashtrimit, horrave e hajdutëve, intrigantëve e hipokritëve, histerikëve e të frustruarve, të cilët njëherazi hedhin litarët të të tërheqin në habitatin e tyre, të pistë e të neveritshëm.

Vetes - Hija e së shkuarës na ndjek pas, sado të mundohemi të baltosim të tjerët, balta që ka ngjitur prej bëmave ndër vite nuk ç’ ngjitet më.

Të ndërtosh kështjella ditën me intrigat e natës, të ndërtosh ide mbi të kundërtën e mendimit, do të thotë të bësh filozofi, mbi bazat e asgjësë dhe për asgjë, por në shërbim të vetes.

Mund t’i shërbejmë në 1001 mënyra, por ajo që do të na shërbente vërtet është që ta ndërtonim veten me ndihmën e vetes, jo duke vënë në shërbim të vetes më të keqen e vetes dhe të tjerëve.

Ndoshta e gjitha kjo do të ishte e pamundur në një botë si kjo...

Ndoshta individë të tillë edhe i shërbejnë botës, na shërbejnë të gjithëve, ndryshe nuk do të mësonim të keqen, të ligën, nuk do të dinim nga se të mbroheshim dhe si të mbroheshim, ndoshta me specie të tilla duhet të ‘luftosh’ por jo të mendosh që s’duhet të ekzistojnë, ndoshta ekzistenca e tyre na bën më të fortë, përballë figurës së tyre të mjerë.....

Ndaj bota është e bukur, kur je i pastër, i drejtë, i formuar, i moralshëm ke fuqinë të luftosh me çdo “hienë” që të del para.

Kam dashur të besoj se në thellësinë e fundme të Njeriut dhe të Njerëzores ka sidoqoftë një shkëndijë të së Mirës, që si edhe na mësojnë Librat e Shenjtë të çdo feje, e kemi dhuratë Hyjnore që në ngjizjen tonë më të hershme.

E pra, kjo shkëndijë duhet të vendosë një Cak, një tavan, përtej të cilit, pa kuptuar se si, të bërit keq për qytetin, fshatin apo detin tënd, duhet të bërtasë diku në brendësi të këtyre krijesave mëkatore.

Duke respektuar mosbesimtarët, që këtë shkëndijë nuk e njohin, do të doja të besoja se, së paku arsyeja e shëndoshë do të bërtiste edhe ajo.

Në shumë filma hollivudianë,

heronj imagjinarë kthehen pas në kohë përmes makinave të kohës të së ardhmes dhe korrigjojnë krimet e së shkuarës, duke dashur të shmangin tragjeditë e të sotmes apo të së nesërme së tyre. Këta personazhe, duke u kthyer pas në kohë, këpusin disa nga hallkat e zinxhirit të së Keqes, që buron kryesisht nga makutëria njerëzore, duke korrigjuar në mënyrë inteligjente dhe të arsyeshme historinë njerëzore të një shekulli më pas.

Mos u nxitoni të më kujtoni që Makina e Kohës nuk është shpikur ende.

#### Jeta dhe dimensionet e saj

Ndërkohë që arrijmë rekorde historike në të gjitha fushat, në

padrejtësia ajo që i bën miliona fëmijë të vdesin nëpër botë, kryesisht në Afrikë, edhe pse ky kontinent është më i madhi dhe më i pasuri nga të gjithë. Jeta e sotme është materiale dhe jo shpirtërore, prona personale e bën poseduesin të dominojë të varfrin dhe hierarkia e vendosur e bën pasurinë, ëndrrën e gjithë atyre që vazhdojnë e besojnë te ky sistem.

Jeta e sotme është sipërfaqësore, vlerat e vërteta kanë humbur dhe bota po bëhet gjithnjë e më pak “njerëzore”. Lehtësitë e komunikimit dhe rrjetet sociale na lejojnë të zgjedhim presidentë, të deklarojmë luftëra, të ndajmë grupet njerëzore dhe

pamundësia e shumicës dërrmuese për të dalë nga dominimi i shëmtuar. Individë të shndërruar në ekuacione ekonomike, të joshur nga përdorimi i teknologjive të reja dhe të paafte të mendojmë për botën që po vjen apo për jetën që i pret. Ndoshta, këtij shekulli i mungojnë filozofët, ata që do të mund të na ofronin një shteg të ri drejt një jete më të mirë!

Jeta e sotme është forma më e re e skllavërisë, tani skllavërit nuk kanë më ngjyrë. Na thonë se duhet të shkojmë në shkollë deri në moshën 20-vjeçare, të punojmë 30 vjet për të pajisur shtëpinë, të cilën do të na duhen 15 vjet për ta paguar, të punojmë për makinën,

kujtesa. Ne jemi sipërfaqësorë, fodullë, të zhveshur nga çdo lloj qëndrimi kritik, të kushtëzuar gjithandëj dhe më e keqja, krenarë për këtë. Të papunin e gjykojmë ngaqë nuk punon, atë që ka punë e konsiderojmë të privilegjuar, ndërsa pensionistin e shohim si dikë që është mënjeluar herët nga shoqëria.

Jeta jonë, është gjithashtu e vetmja shpresë e jona: trashëgimia që na kanë dhuruar shekuj të tërë histori dhe që së bashku po e përmirësojmë, në këtë botë globale e të kushtëzuar dhe mjetet që ne disponojmë për të komunikuar e për t’u organizuar janë më të fuqishme se çdo lloj arme. S’na mbetet tjetër, veç të mësojmë t’i përdorim me zgjuarsi. “Një



shëndetësi, në përhapjen e informacionit, në afatin e zhvendosjes nëpër botë apo të shfrytëzimit të burimeve të jetësore, Njeriu s’ka njohur kurrë kaq shumë varfëri dhe mjerim. Jeta e sotme nuk është më e jona. Jetët tona nuk na përkasin më. Kjo e fundit është kthyer në kompeticion. Njeriu nuk formon më një grup që tenton të rrisë nivelin e tij të ndërgjegjes, por përpigjet vetëm të përmirësojë të përditshmen, të cilën gabimisht kujton se e kontrollon. Kjo na çon drejt bindjes që nuk është

komunitetet në minoritete që përpigjet të mbrojnë grupin e tyre të vogël, në vend që të grumbullohen aty ku bashkimi i popujve do të ishte e vetmja rrugë. Jeta e sotme është një gënjeshtër dhe kjo gënjeshtër institucionalizohet në formën e edukimit kombëtar, një propagandë e gjerë në shkallë botërore, e cila tenton të përgatisë të ardhmen e brezit të ri, i cili e pranon botën e imponuar. Jo nga vullneti i gjithëfuqishëm i një grupi që pretendon të dominojë, por nga

të cilën do të na duhen pesë vjet për ta paguar dhe të përballojmë jetën e përditshme që është gjithnjë e më e shtrenjtë. Dhe kur lodhemi e sëmuremi nga kjo jetë, vijat e përgjithshme të së cilës janë konturuar tashmë, sistemi ka mirësinë të na shpjegojë se vitet e fundit na përkasin dhe mund të vdesim të qetë. Jeta e sotme është e kundërta e asaj që pretendojmë, e kundërta e asaj për të cilën luftojmë. Ajo është një sfidë për t’u përballuar, një faqe të cilën fëmijët tanë ndoshta, do të përpigjet ta fshijnë nga

ditë takova një fëmijë të verbër. Më kërkoi t’i përshkruaja detin, unë duke e parë ia përshkrova. Pastaj më kërkoi t’i përshkruaja botën, dhe unë duke qarë e gënjeva”, mes lotësh dhe dhimbjes që e vërteta e hidhur lë pas, një buzëqeshje e bukur me kaploi fytyrën teksa pashë fëmijën me dritën e syve të fikur, por atë të shpirtit gati të shpërthente lumturie prej ‘Përrallës’ së bukur që dëgjoji për inekzistencën jetë reale!

*Kjo është bota e një të verbri!*

*A nuk është e bukur!?!...*



# "Agresion Ushtarak, Gusht '49"



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

**S**tudimi i provokacionit, apo agresionit, ushtarak të gushtit të vitit 1949, përbën një pjesë të rëndësishme të historisë së Ushtrisë Kombëtare shqiptare dhe të popullit shqiptar. Trajtimi i këtij provokacioni apo agresioni është një detyrë e rëndësishme e historiografisë shqiptare në përgjithësi dhe të asaj ushtarake në veçanti. Edhe pse provokacionet apo agresioni ushtarak i gushtit të vitit 1949 nuk ka mbetur jashtë vëmendjes të historiografisë shqiptare, studimet për të, sidomos të karakterit monografiko-ushtarake kanë qenë tepër të kufizuara.


Në dhjetëvjeçarin e parë pas tij, deri nga vitet 1960, nuk rezultojnë se është bërë ndonjë punë studimore e organizuar për këtë agresion.

Në vitet më pas, një punë më e organizuar filloi të bëhej në trajtesa të shkëputura, si dhe provokacionet janë trajtuar shkurt, gjithmonë të natyrës së historisë politike, në veprën kolektive "Historia e popullit shqiptar", vëll. 4, të botimit të Akademisë së Shkencave.

Në këtë përpjekje të parë por, gjithsesi të admirueshme, në këtë libër janë shfrytëzuar burime në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura (AQFA), në Arkivin Qendror të Shtetit (AQSH), në Arkivin e Ministrisë së Brendshme (AMB), në Arkivin e Ministrisë të Punëve të Jashtme (AMPJ), në periodikët e përditshëm qendror "Zëri i Popullit", "Bashkimi", "Luftëtari", gazetave lokale të kohës, si dhe në ditarin e veprimeve luftarake të postës "Hero i Popullit" të Vidohovës dhe të Trestenikut, të cilat japin të dhëna me interes për ndriçimin e aspekteve të shumta të agresionit.

Po kështu, janë shfrytëzuar plane, harta e dokumente të ushtrisë që ndodhen në arkiva. Njëkohësisht janë shfrytëzuar analiza, trajtesa, si dhe konkluzione për këto ngjarje, duke u mbështetur në studime të dokumenteve të kohës dhe në materialet e drejtuesve kryesor të Shtetit Shqiptar të asaj periudhe, si të Enver Hoxhës, Mehmet Shehut etj.

Me vlera të mëdha reale dhe besueshmërie gjejmë në qasjet e librave të autorit Resul Bedo, pjesëmarrës aktiv në këtë agresion, në botimet: "Ky vend ka zot", viti 1964, "Yje të



Pashuar" vëll. XI dhe XIX, botime të vitit 2009. Kjo ngjarje ka gjetur pasqyrim edhe në revistën "Studime Historike", nr. 4. 1969 me autor Prof. Mentar Belegun, me titull "Dështimi i komplotit imperialist e monarko-fashist të gushtit 1949, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë", e përcjellë nën këndin e historisë politike. Pra, në tërësi në botimet e mësipërme, agresioni ushtarak analizohet në këndvështrimin politiko-shoqëror e me ndonjë trajtesë tepër të përgjithshme në aspektin e historisë ushtarake.

Nga ana tjetër, natyrisht që është hedhur dritë me fakte, por edhe një shtysë të veçantë ka marrë trajtesa "Veprimet luftarake të Ushtrisë Popullore për thyerjen e provokacioneve të monarko-fashistëve grekë kundër vendit tonë gusht 1949", e përgatitur nga ish-Katedra e Historisë së Artit Ushtarak në Akademinë Ushtarake (sot Akademia e Forcave të Armatosura - AFA), në vitin 1989. Me interes janë shfrytëzuar dhe trajtesat e bëra nga Institucioni arsimor më i lartë i Forcave të Armatosura para viteve

1990, kryesisht nga Prof. Shahin Leka dhe Dr. Avni Hajro.

Gjithashtu janë studiuar me vëmendje një varg artikujsh botuar në revista të ndryshme shkencore por sidomos, një ndihmesë të madhe kanë dhënë njohja e diskutimeve që u zhvilluan në sesionin shkencor, i cili u organizua më 2 gusht 1984, me rastin e 35-vjetorit të zhvillimit të operacionit mbrojtës të Ushtrisë Popullore kundër agresionit monarko-fashist grek.

Ndërkohë, është më se i dukshëm, studimi i thelluar dhe profesional nga ushtaraku Gaqo Joro, në disertacionin me temë: "Operacioni mbrojtës kundër agresionit monarko-fashist grek në gusht të vitit 1949", në Akademinë e Mbrojtjes më 25.9.1986, studim, i cili, fatkeqësisht nuk ndodhet i depozituar në bibliotekën e AFA-së dhe në Bibliotekën Kombëtare.

Pas rënies së diktaturës të proletarietit dhe kalimin në sistemin e demokracisë pluraliste, në botimet e pas viteve 1990, pavarësisht nga përpjekjet e studiuesve për të dhënë punime studimore, ato kanë qenë të

pakta, sidomos në gazeta dhe më pak në revista shkencore.

Në fazën e grumbullimit të literaturës botuese u ndalëm edhe në botimin e autorit Zaho Golemi, "Taktika e ushtrisë shqiptare në vitet 1945-1975", viti 2005, në të cilin hidhet dritë për taktikat e përdorura nga forcat e postave kufitare në këto provokacione të gushtit 1949. Një trajtesë spikatëse është bërë edhe nga nënkolonel Jorgo Qirici, në shkrimin studimor me objekt "Lufta në kufi me Greqinë, përballimi i provokacioneve nga rojet kufitare shqiptare". Një vlerë e shtuar për këtë monografi shpresojmë që të jetë vëmendja dhe analiza e veçantë që i kemi kushtuar edhe studimit të terrenit ku u zhvilluan këto luftime.

Të gjitha këto burime të mirëfillta na kanë ndihmuar për një konceptim sa më të gjerë të qëllimeve, planeve e ideve të të dy palëve dhe për një përfytyrim më të plotë e më të saktë të përdorimit të metodave të luftimit. Pavarësisht botimeve të përmendura më lart, autorët vënë re se ende

**Autorët shpresojnë shumë që ky libër do të vlerësohet si një përpjekje pozitive, si një gur i vogël i shkëputur nga mozaiku i veprës heroike të Ushtrisë Shqiptare për mbrojtjen territoriale të Shqipërisë tonë të dashur. Kështu, besojmë se do të ndihmojmë për të njohur, mësuar dhe edukuar brezat dhe njerëzit me kulturën e domosdoshme të përkujtimit dhe vlerësimit të luftës së tyre. Këtë detyrë e kemi plotësuar me monografinë "Agresioni ushtarak-Gusht '49".**

mungojnë studime të mirëfillta të karakterit monografik dhe veçanërisht në fushën e historisë e artit ushtarak në interes të studiuesve dhe institucioneve ushtarake, që merren me studimin dhe publikimin e historisë ushtarake, gjithmonë në trajtën e monografive apo punimeve të tjera.

Kjo punë, përveç anës së vlerësimit të veprës e të jetës të ushtarakëve shqiptarë, në të mirë të vendit e të Ushtrisë, për më tepër do të sjellë materiale me shumë vlera njohëse dhe profesionale në bibliotekën e historisë ushtarake shqiptare, pse jo edhe të huaj. Autorët shpresojnë shumë që ky libër do të vlerësohet si një përpjekje pozitive, si një gur i vogël i shkëputur nga mozaiku i veprës heroike të Ushtrisë Shqiptare për mbrojtjen territoriale të Shqipërisë tonë të dashur. Kështu, besojmë se do të ndihmojmë për të njohur, mësuar dhe edukuar brezat dhe njerëzit me kulturën e domosdoshme të përkujtimit dhe vlerësimit të luftës së tyre. Këtë detyrë e kemi plotësuar me monografinë "Agresioni ushtarak-Gusht '49".



# Armët ilire, finesë, stil, forcë, krenari e lashtësisë shqiptare

**A**rmët ilire luajtën një rol të rëndësishëm në përbërjen e ushtrive ilire dhe në konfliktet ku përfshiheshin ilirët. Nga të gjitha burimet e lashta, shkrimet më të rëndësishme dhe më të bollshme janë ato të Ennius (239-169 p.e.s.), një poet romak me origjinë mesapiane. Armët e të gjitha llojeve u vendosën gjithashtu të paprekura në varret e luftëtarëve ilirë dhe ofrojnë një pasqyrë të detajuar për arkeologët mbi shpërndarjen dhe zhvillimin e armatimit ilir.

## Mburojat

Mburojat janë përdorur tek ilirët që nga fundi i epokës së bronzit, por shumë pak dihet për mburojat e hershme deri në epokën e hekurit. Në këtë periudhë mburojat ilire bëheshin prej druri dhe lëkure dhe si rrjedhojë nuk ka mbetur asnjë shembull i tillë. Gjatë epokës së hekurit, mburojave iu ngjiti një pllakë metalike. Mburoja më e zakonshme ilire ishte mburoja rrethore, megjithëse ilirët e veriut dhe japodët përdornin gjithashtu një tip mburojash ovale ose drejtëndëshe. Mburoja rrethore ishte e vogël dhe ishte e zbuluar me rrathë dhe gjysmërreth të ngulitur në anët e saj. Ajo i ngjante mburojës maqedonase të asaj kohe, por ndryshonte për nga numri i rrathëve, të cilët ishin një dekorim simbolik. Një nga shembujt më të mirë të mburojës rrethore ilire, të veshur me bronz, u gjet në një nekropol liburnian në Nin dhe daton në shekullin e IV p.e.s. Mburoja rrethore u përdor gjerësisht që nga Glasinaci në Bosnje deri në Shqipëri dhe Kosovë. Ato janë paraqitur në monedhat e qytetit ilir të Lezhës dhe Shkodrës. E ngjashme me mburojën ovale ilire në Ilirinë veriore ishte edhe mburoja që keltët sollën me vete gjatë pushtimit galik në Ballkan në shekujt IV-III p.e.s. Mburoja kelte ishte prej druri dhe e zgjatur, me një bos hekurit.

## Armatura e gjoksit

Armatura e gjoksit ishte një pjesë e rrallë dhe shumë interesante e armaturës ilire. Një lloj parzmore e gjoksit prej pllake bronzi përdorej vetëm nga ilirët e veriut. Deri më tani vetëm tre prej tyre janë zbuluar në Novo Mesto, Sticna-Verpole dhe St. Vid. Të gjitha datojnë në periudhën para vitit 500 p.e.s. Ilirët e tjerë nuk përdornin parzmorin e gjoksit. Vetëm ilirët e Glasinacit përdornin një lloj armature gjoksi, nëse armatura e gjoksit mund të konsiderohet një xhakë prej pëlhure ose lëkure me pjesë bronzi. Një formë tjetër e armaturës së trupit ishte një kraharor bronzi që mund të ketë mbrojtur edhe një pjesë të shpinës. Ishte më shumë si një "pllakë kraharori" me disk 10cm në diametër.

## Mburojat e këmbëve

Në shekullin VII p.e.s., mbrojtëset për këmbët prej bronzi u përdorën nga luftëtarët ilirë. Është e mundur që ilirët kanë përdorur zhavorre lëkure në një kohë më të hershme, e njëjta me ato të përdorura nga mikenasit, por nuk dihet asgjë për to. Tharkat prej bronzi shfaqen për herë të parë tek ilirët në Ilirinë e Jugut, ku janë gjetur shembuj që datojnë në shekullin e VII para Krishtit, si dhe nga Glasinaci i së njëjtës periudhë. Gjërat prej bronzi të zbuluara në varrin e një princi në Gllasinac janë interesante veçanërisht për dekorimet e paraqitura në to. Në sipërfaqet e jashtme janë gdhendur anije luftarake, rrathë dhe motive trekëndore. Dy dekoratat e përmendura së fundi besoj se mbronin luftëtarin gjatë luftimeve. Deri në epokën romake zhavorret prej bronzi përdorëshin rrallë dhe vetëm nga luftëtarët e pasur.

## Helmetat

*Përkrenaret ilire dhe Helmeta e tipit ilir.*

Helmetat gjenden më shumë në varret ilire për shkak të statusit të tyre më të lartë. Helmetat prej bronzi janë bërë nga ilirët e veriut nga shekulli i VII p.e.s. Në atë kohë dhe ndoshta më herët përdorej përkrenarja konike.

Më vonë në këto zona u përdor nga Japodët përkrenarja e Shmarjetit, e quajtur sipas Shmarjetit të Novo Mestos.



## Përkrenare e tipit ilir nga Argolisi, Greqi


Kjo lloj helmete shumë interesante ishte e ngjashme me kapelat e rumbullakëta japodiane. Ato ishin bërë nga skeletet e shkurreve dhe të lyera me argjilë. Disqe të rumbullakëta bronzi dhe stufa shpesh vendoseshin rreth helmetës. Kishte dy varietete, një me bazë thurje dhe një të qepur së bashku me postë zinxhir. Deri më tani janë gjetur tridhjetë helmeta shmarjetit.

Tek ilirët e veriut përkrenarja prej bronzi u zhvillua në përkrenare konike ose përkrenare tenxhere. Përkrenarja konike u përdor në shekullin e 6 p.e.s. dhe ndonjëherë kishte një tufë pendësh zbuluese. Nga shekulli V-IV p.e.s. nën ndikimin e etruskëve dhe popujve të tjerë italianë, helmeta negau u përdor edhe nga ilirët e veriut. Agrianët, që ishin në kontakt të ngushtë me maqedonasit dhe trakët përdorën përkrenaren e tipit frigjian.

Përkrenarja më e rëndësishme dhe më e përhapur ishte "helmeta e tipit ilir", e cila kishte origjinën në Peloponez, Greqinë e lashtë. Helmeta të këtij lloji janë zbuluar në shumë vende në Shqipëri, Kosovë, Bosnje, Kroaci (afër bregdetit), Maqedoninë e Veriut etj. Shumë shkencëtarë i datojnë helmetat më të vjetra ilire nga Greqia e shekullit të VII p.e.s. dhe sipas tyre helmetat e mëvonshme të gjetura në Ilirinë e Jugut gjithashtu nga shekulli VII p.e.s. janë të importuara nga Greqia. Megjithatë, ekspertë të tjerë, veçanërisht arkeologu shqiptar Hasan Ceka, paraqesin argumente në favor të helmetës autoktone ilire. Sipas Cekës, përkrenarja ilire është një përkrenare origjinale ilire që daton nga shekulli VII p.e.s. dhe

përdoret deri në shekullin II p.e.s., dhe jo vetëm deri në shekullin e IV p.e.s., siç mendohej më parë. Dëshmi për një përdorim të tillë të vonë na ofrojnë përshkrimet e përkrenares në monedhat ilire, veçanërisht ato të mbretit Gent. Helmetat ishin një privilegj i kufizuar për pakicën e luftëtarëve që mund t'i përballonin ose t'i siguronin ato.

## Shpata



## Sika, arma e lashtë e ilirëve

Shpata kryesore luftarake ilire ishte sika, një shpatë e shkurtër e lakuar me një teh, e përdorur nga gladiatorët thraex në botën romake. Sika u zhvillua gjatë epokës së bronzit dhe ishte e ngjashme me machairan greke. Fillimisht u përshkrua si një shpatë e lakuar me një teh rreth 16-18 inches (41-46 cm) të gjatë. Forma dalluese ishte projektuar për të kapërcyer anët e mburojës së kundërshtarit në mënyrë që të mund ta godiste atë në shpinë. Edhe pse sika përdorej nga shumë popuj rreth Ballkanit, romakët e konsideronin shpatën e tipit sika si një armë të veçantë ilire, të përdorur edhe nga banorët e Shqipërisë së sotme, Dalmacisë dhe Kroacisë së sotme, pjesë të Bosnjës dhe Hercegovinës. Një tjetër lloj shpate ilire ishte shpata luftarake, e cila ishte 20-30cm e gjatë. U përdorën gjithashtu shpata të shkurtra të lakuara dhe shpata të gjata. Përveç kësaj, ilirët përdornin thika të ndryshme.

## Shtiza

Ilirët përdornin shtizat shtytëse dhe sabinën, e cila ngjante me një shtizë derri. Sibina ishte një shtizë e gjatë metalike dhe gjendet rëndom në të gjithë Ilirinë, por veçanërisht në nekropolin e Bosnjës.

## Armatime të tjera

Harku dhe shigjeta, të përdorura gjerësisht nga ilirët që nga mijëvjeçari II p.e.s., u bënë një armë e rëndësishme për këmbësorin ilir. Ndër sëpatat e përdorura ishin sëpata luftarake dhe sëpata me një dorë. Karrocet dihej se përdorëshin nga daunët dhe ilirët e veriut në Slloveni vetëm nga përshkrimet e stelës dauniane dhe situlës ilire. Mund të kenë qenë të përhapura në të gjithë Ilirinë, por nuk është zbuluar asnjë e vetme.





PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Njëzet e tre aleatë të NATO-s janë bërë zyrtarisht partnerë të kufizuar të Fondit të Inovacionit të NATO-s (NIF), i cili po përgatitet të bëjë investimet e tij fillestare këtë vit. Aleatët pjesëmarrës të NATO-s, (Belgjika, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar), kanë mirëpritur gjithashtu interesin e Suedisë për t'u bashkuar me NIF. Por pjesëmarrja e Suedisë do të hyjë në fuqi me pranimin e saj në Traktatin e Atlantikut të Veriut.

Kontributi i Suedisë do t'i shtohet fondit aktual të kapitalit sipërmarrës prej 1 miliard euro, duke rritur kapitalin e investueshëm të Fondit të Inovacionit të NATO-s dhe duke forcuar kapacitetin inovativ në të gjithë Aleancën.

“Si një anëtare e NATO-s, Suedia do të kontribuojë në fuqinë e Aleancës, jo vetëm nëpërmjet vendndodhjes sonë gjeo-strategjike dhe aftësive ushtarake, por edhe nëpërmjet një industrie jetike sigurie dhe mbrojtjeje që promovon inovacionin dhe zhvillimin e teknologjisë së fundit. Kjo mundësohet më tej përmes pjesëmarrjes në Fondin e Inovacionit të NATO-s”, - tha Pål Jonson, ministër i Mbrojtjes i Suedisë.

Z. David van Weel, Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Sfidat e Sigurisë emergjente, përshëndeti pjesëmarrjen e ardhshme të Suedisë. “Samiti i këtij viti e vendosi Suedinë më tej në rrugën e duhur për t'u bërë vendi i 32-të që do t'i bashkohet Aleancës sonë dhe ky hap historik do t'i hapë rrugën Suedisë për të marrë pjesë në Fondin e Inovacionit të NATO-s dhe për të kontribuar në misionin e saj të rëndësishëm”, - tha ai.

Fondi i Inovacionit të NATO-s është fondi i parë në botë i kapitalit sipërmarrës shumë sovran dhe do të investojë në bizneset fillestare që zhvillojnë zgjidhje teknologjike të fundit, duke shfrytëzuar potencialin për inovacionin tregtar për të adresuar sfidat kritike të mbrojtjes dhe sigurisë. Partnerët e kufizuar të Fondit përfshijnë 23 aleatë të NATO-s në nivelet më të larta të qeverisjes, kapitalit sipërmarrës, inovacionit dhe mbrojtjes. Fondi do të bëjë investime të drejtpërdrejta në bizneset fillestare të vendosura në cilindo nga 23 vendet aleate pjesëmarrëse, si dhe investime indirekte në fondet e teknologjisë së thellë me një ndikim transatlantik. Ai do të sigurojë kapitalin e duhur për të përmbushur nevojat dhe afatet kohore të novatorëve të teknologjisë së thellë dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për 1 miliard qytetarët e Aleancës.

#### Nevoja e krijimit të Fondit të Inovacionit

Investimi i shumës prej 1 miliard eurosh do të kryhet në teknologjinë e thellë për të siguruar të ardhmen e 1 miliard qytetarëve të Aleancës. Fondi i Inovacionit të NATO-s (NIF) u krijua për të plotësuar ekosistemet unike të inovacionit të Aleancës. Talentet aleate dhe kërkimi në Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë (STEM) janë lider në botë, por tregu për të mbështetur inovacionin e thellë të teknologjisë është i pa financuar. Me NIF, po krijohet një makinë komercializimi si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, duke mbështetur novatorët për të siguruar të ardhmen për 1 miliard qytetarët e Aleancës.

Nga ana tjetër shohim se fokusimi i NIF, është një fond i pavarur i kapitalit sipërmarrës prej 1 miliard eurosh, që mbështet themeluesit ambiciozë që zhvillojnë teknologji në zhvillim dhe përçarës. Mbështetja me ndikim të lartë përfshin inteligjencën artificiale (AI), bioteknologjinë, energjinë dhe shtytjen, prodhimin dhe hapësirën. NIF është i apasionuar pas autonomisë, hipersonikës, materialeve të reja dhe kuantikës, kërkon të mbështesë harduerin dhe softuerin më të fundit. Duke u bashkuar rreth teknologjive të reja dhe përçarëse (EDT) të NATO-s, fokusi i NIF do të evoluojë paralelisht me mjedisin e sotëm të shpejtë të inovacionit.

Me një pamje afatgjatë, NIF ka objektiv të mundësojë teknologjitë transformuese me potencialin për të formësuar sigurinë aleate për dekadat në vijim dhe ka mision thelbësor kërkimin e zhvillimeve të fundit që zgjidhin sfidat e NATO-s përmes adoptimit në tregjet e mbrojtjes dhe sigurisë; forcimi i kapaciteteve të ekosistemeve aleate të inovacionit; dhe përfundimisht duke nxitur shkallën dhe suksesin e portofolit tonë.

#### Përfshirja e Suedisë në NIF dhe marrëdhëniet e saj me NATO-n

Aleatët kanë mirëpritur interesin e Suedisë për t'u bashkuar me NIF, por pas anëtarësimit të saj në NATO. Pas gati 30 vitesh partneritet të ngushtë me NATO-n, Suedia paraqiti letërën e saj zyrtare të aplikimit për t'u anëtarësuar në Aleancë në maj 2022. Partneriteti i Suedisë me NATO-n bazohet historikisht në politikën e saj të mos-angazhimit ushtarak, e cila ndryshoi pas pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë, në shkurt 2022. Që nga 5 korriku 2022, Suedia ka qenë një e ftuar zyrtare në NATO, duke marrë pjesë në takime dhe duke koordinuar aktivitetet me aleatët. Ajo do të bëhet një aleat i NATO-s pasi të gjithë aleatët të kenë ratifikuar Protokollin e saj të Anëtarësimit.

Ndërkohë si një vend partner i NATO-s, Suedia zhvillon një dialog politik të hapur dhe të rregullt dhe angazhohet në një gamë të gjerë bashkëpunimi praktik me Aleancën. NATO dhe Suedia bashkëpunojnë në mënyrë aktive në operacionet e mbështetjes së paqes, ushtrohen së bashku dhe shkëmbejnë analiza dhe informacione. NATO ka respektuar plotësisht politikën historike të Suedisë për mos-angazhim ushtarak. Bashkëpunimi filloi kur Suedia iu bashkua programit të Partneritetit për Paqe (PfP) në 1994 dhe Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (një forum shumëpalësh për dialogun që bashkon të gjithë aleatët dhe vendet partnere në zonën euro-atlantike) në 1997. NATO dhe Suedia kanë fusha të detajuara bashkëpunimi dhe afate kohore në Programin e Bashkëpunimit të Partneritetit Individual të Suedisë (IPCP), i cili

# Fondi i Inovacionit të NATO-s mbyllet me 1 miliard euro

*Përfshihen në fond 23 aleatë në nivelet më të larta të qeverisjes, kapitalit sipërmarrës, inovacionit dhe mbrojtjes*



është rënë dakord bashkërisht për një periudhë dyvjeçare.

Suedia ka qenë një nga partnerët më aktivë të NATO-s dhe një kontribuues i çmuar në Misionin e Mbështetjes Vendimtare të Udhëhequr nga NATO në Afganistan, Forcën e Kosovës (KFOR) në Kosovë dhe Misionin e NATO-s në Irak (NMI). Si një “Partner i Mundësisë së Përmirësuar”, (një vend partner që jep kontribute veçanërisht të rëndësishme në operacionet e NATO-s dhe objektivat e tjera të Aleancës), Suedia ka përjetuar mundësi të zgjeruara për dialog dhe bashkëpunim me aleatët.

Pas pushtimit të plotë të Rusisë në Ukrainë, që filloi në shkurt 2022, Suedia (së bashku me Finlandën) paraqiti më 18 maj 2022 letërën e saj zyrtare të aplikimit për t'u bërë aleate e NATO-s dhe më 4 korrik 2022, pas Samitit të liderëve të NATO-s në Madrid, Suedia dhe Finlanda përfunduan bisedimet e pranimit në selinë e NATO-s dhe 30 aleatët e atëhershëm nënshkruan Protokollin e Aderimit për të dy vendet të nesërmen. Pasi Protokollin i Anëtarësimit të Suedisë të ratifikohet nga të gjitha vendet anëtare të NATO-s sipas procedurave të tyre kombëtare, vendi do të bëhet një aleat i NATO-s. Kurse Finlanda u bashkua me NATO-n më 4 prill 2023, pas përfundimit të procesit të anëtarësimit.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg ka theksuar rëndësinë që edhe Suedia t'i bashkohet Aleancës sa më shpejt të jetë e mundur. Pasi Protokollin i Anëtarësimit të Suedisë të ratifikohet nga të gjitha vendet anëtare të NATO-s sipas procedurave të tyre kombëtare, vendi do të bëhet gjithashtu një aleat i NATO-s.

NATO dhe Suedia prej kohësh ndajnë vlera të përbashkëta. Si një nga partnerët më të ngushtë të NATO-s, bashkëpunimi i Suedisë me Aleancën ka qenë reciprokisht i dobishëm dhe përfshin, ndërtime dhe aftësive dhe ndërveprimet; Mbështetje për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO; si dhe një bashkëpunim edhe më të gjerë.

#### Ndërtimi i aftësive dhe ndërveprimet

Suedia mori pjesë në Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit të PfP-së (PARP), i cili i ndihmon vendet të zhvillojnë aftësitë e tyre ushtarake dhe rrit ndërveprimin midis forcave aleate dhe partnere. Suedia mori pjesë në Konceptin e Kapaciteteve Operacionale të NATO-s (OCC), i cili përdor një program vlerësimi dhe reagimi për të zhvilluar dhe trajnuar njësitë partnere tokësore, detare, ajrore ose të Forcave të Operacioneve Speciale që kërkojnë të përmbushin standardet e NATO-s. Suedia mori pjesë në stërvitje të shumta të PfP-së dhe gjithashtu në stërvitjet e Koalicionit Kibernetik të NATO-s. Suedia po bashkëpunon me disa vende të tjera për të zhvilluar një forcë shumëkombëshe të reagimit të shpejtë për operacionet e mbështetjes së paqes të udhëhequra nga Bashkimi Evropian (BE). Duke filluar nga viti 2014, nën Iniciativën e Ndërveprueshmërisë së Partneritetit, Suedia mori pjesë në Platformën e Ndërveprueshmërisë, e cila bashkon aleatët me partnerë të përzgjedhur që janë kontribuues aktivë në operacionet e NATO-s. Suedia merr pjesë në iniciativën Strategic Lift Capability (SAC). Roli i Suedisë në trajnimin e forcave të vendeve partnere të NATO-s vlerësohet shumë nga Aleatët. Qendra Ndërkombëtare e Forcave të Armatosura Suedeze (SWEDINT) ofron stërvitje dhe trajnime me fokus në ndihmën humanitare, shërbimet e shpëtimt, operacionet e mbështetjes së paqes, gatishmërinë civile dhe kontrollin demokratik të forcave të armatosura. Qendra Nordike për Çështjet Gjinore në Operacionet Ushtarake ndodhet gjithashtu në SWEDINT. Suedia ka lidhje të ngushta me vendet e tjera nordike dhe merr pjesë në Bashkëpunimin e Mbrojtjes Nordike (NORDEF), një nisimë rajonale e mbrojtjes që promovon bashkëpunimin midis forcave të armatosura nordike.

#### Mbështetje për operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO

Suedia së pari kontribuoi në një operacion të udhëhequr nga NATO në 1995, kur dërgoi një batalion në forcën paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO në Bosnje-Hercegovinë. Suedia ka mbështetur forcën paqeruajtëse të udhëhequr nga NATO në Kosovë (KFOR) që nga viti 1999. Personeli suedez punoi së bashku me forcat aleate si pjesë e Forcës Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë (ISAF) në Afganistan nga viti 2003 deri në përfundimin e misionit të ISAF-it në 2014. Suedia gjithashtu mbështeti Misionin e Mbështetjes Vendimtare (RSM) për të trajnuar, ndihmuar dhe këshilluar më tej forcat dhe institucionet afgane të sigurisë deri në përfundimin e tij në shtator 2021. Suedia kontribuoi mbi 13 milionë USD në Fondin e Mirëbesimit të Ushtrisë Kombëtare Afganistan. Në prill 2011, Suedia kontribuoi në Operacionin Mbrojtësi i Unifikuar (OUP), operacioni ushtarak i NATO-s në Libi sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1970 dhe 1973. Suedia gjithashtu merr pjesë në Misionin e NATO-s në Irak (NMI), misionin këshillues dhe për ndërtimin e kapaciteteve të NATO-s në Irak. Suedia mori pjesë në Forcën e zgjeruar të Reagimit të NATO-s (NRF) në një rol plotësues dhe subjekt i vendimeve kombëtare. Për më tepër, Suedia ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për Mbështetjen e Vendit Pritës, i cili, në varësi të një vendimi kombëtar, lejon mbështetjen logjistike për forcat aleate të vendosura në tranzit përmes territorit të saj gjatë stërvitjeve ose në një krizë.

#### Bashkëpunim më i gjerë

Suedia është angazhuar me Komitetin e Rezistencës së NATO-s dhe bashkëpunon me aleatët për vlerësimet rajonale, mbrojtjen kritike të infrastrukturës dhe ofrimin e mbështetjes në trajtimin e pasojave të një aksidenti ose fatkeqësie të madhe në zonën Euro-Atlantike.

Suedia ka marrë pjesë në stërvitje të shumta të NATO-s për menaxhimin e krizave dhe burimet civile suedeze janë renditur në Qendrën Euro-Atlantike të Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC), duke përfshirë ekipet e kërkim-shpëtimt, ekspertët mjekësorë dhe njësitë e mbrojtjes dhe dekontaminimit. Suedia kryen rregullisht ushtrime të mëdha multifunkionale policore civilo-ushtarake (stërvitjet Viking), të cilat përfshijnë shumë vende të tjera si dhe pjesëmarrës nga organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe agjencitë. Në Programin e NATO-s “Shkencë për Paqe dhe Siguri” (SPS), shkencëtarët suedezë po kontribuojnë aktivisht në një numër aktivitetesh që kanë të bëjnë me mbrojtjen kundër terrorizmit, kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN) dhe sigurinë mjedisore. Veçanërisht, ekspertët nga Suedia janë të përfshirë në një projekt nga lart-poshtë me objektivin kryesor të ndërtimit të kapaciteteve afatgjata për vlerësimin e programeve për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm.

Suedia mbështet në mënyrë aktive zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (WPS), dhe që nga viti 2012 ka pritur Qendrën Nordike Gjinore për Operacionet Ushtarake në Qendrën Ndërkombëtare të Forcave të Armatosura Suedeze, për të siguruar që perspektivat gjinore të vazhdojnë të të integrohen në operacionet ushtarake. Suedia ka mbështetur një sërë projektesh të Fondit të Mirëbesimit të NATO-s në vendet partnere, të fokusuar në fusha të tilla si trajnimi dhe vlerësimi i njëjësive ushtarake; rehabilitimi mjekësor i personelit ushtarak të lënduar; asgjësimi dhe luftimi i mjeteve shpërthyes të improvizuara; dhe zhvillimin profesional të punonjësve të sektorit të sigurisë.



# "Të jesh grua në Shqipëri është punë burrash"

**Fisnikja, e bukura, forca, kanë një emër: "Grua"**

"Të jesh grua në Shqipëri është punë burrash", teksa në hulumtimet e miya mes qindra opinionesh të ndryshme mbi femrën shqiptare, por jo vetëm, hasa këtë shprehje, "e bukur, e trishtë por e vërtetë!", - mendova.

**Por si shihet femra, qeliza që lind jetën?**

Gruaja, kjo qenie e brishtë, hyjnia e bukurisë së lashtësisë (Afërdita e grekëve të lashtë apo Venera e romakëve) në këtë gen duhet të jetë njeriu që përballet gjithëherët me tragjikën.

Historia e këtij kombi të dhunshëm e agresiv, të cilit i përkasim, gjithmonë femrën e ka pasur kultin e mundimeve, të punës dhe të fljimeve.

Është pjella që nuk trashëgon prej trugut të saj familjar të drejtën e pronësisë së mbiemrit të lindjes. (Madje as të drejtën e pronës që nga Kanuni i Lekë Dukagjinit: Gruaja shqiptare farë trashëgimit s'ka tek prindja, as më plang, as në shpi- kanuja e xen gruen si një tepricë në shpi).

Shprehje të tilla si: "vajza është derë e huaj", "djali i saj është i huaj, nuk trashëgon si djali i djalit mbiemrin e trugut familjar të nënës", "vajza sjell një derr në shtëpi (dhëndrin) e shqyr zotit që e martuam", etj., etj., janë shprehje të hapura të një racizmi të trashëguar nga patriarkaliteti që himnizon mashkullin.

Pra, qenia e saj e mbyt familjen që në lindjen e vet. Një karakteristikë që shpreh psikologjinë e pritjes së një fëmije të sapolindur është zakoni i të shkrepurit të pushkës me lindjen e djalit dhe heshtja totale me lindjen e vajzës në të kaluarën e ndofta edhe sot në një pjesë të madhe të shqiptarëve.

Në kohën e Komunizmit në Shqipëri shumë baballarë nuk i afroreshin maternitetit kur gruaja e vet lindte vajzë. Ndër kohëra të vjetra e deri më sot për shqiptarin ndryshe përjetohet lindja e një djalit për pushkë dhe ndryshe lindja e një vajze për punë.

Sa tragjike ardhja e një gruaje në jetë! "Mjerë ti o e shkretë, që linte femër!", - vajtonin nënat tona të sunduara nga pushteti i patriarkalitetit.

Gruaja, figura më tragjike e familjes, kishte e ka privime të vazhdueshme nga të drejtat e saj. Shprehje të tilla si: "Gruaja është me shpatulla pas murit", "Mbyll gojën se është turp, je femër", nëse nuk tregojnë diskriminim social dhe dhunë psikologjike mbi femrën, çfarë tjetër tregojnë?

Të lindësh grua në Shqipëri ku një në tre femra dhunohen fizikisht dhe dy në tre psikologjikisht është vërtetë tragjike. Të lindësh grua në Shqipëri do të thotë të mos mundesh të jetosh pa çatinë e një mashkulli babës, vëllait, burrit.

Pa një çati të tillë gruaja është lënëshë, e padenjë, e pamoralshme, e fëlliqur, e mjerë, qyqare e ku di unë, gjithfarë epitetesh fyese, përrulëse e keqardhëse, një klasë shoqërore në moshë të mesme ndër më të përcëmuarat, më të përbuzurat nga shqiptari.

Pothuajse asnjë shqiptar akoma edhe sot në shek. XXI nuk mund të konceptojë një grua të vetme në shtëpi larg babait, vëllait e të afërmeve nëse është e pamartuar, ose nuk bashkëjeton me dikë.

Të gjitha vajzat shqiptare të pamartuara në Shqipëri edhe për shkak të mungesës së të mirave materiale, pasi gruaja paguhet minimalisht në Shqipëri për të përballuar e vetme jetën, jetojnë me prindërit nën klimën e nënshtrimit të pretendimeve prindërore për shërbim dhe privimit të lirive të saj jetësore.

Ashpërsia dhe vrazhdësia tragjike mbi femrën e konsoliduar prejshëkuajsh në ndërgjegjen shqiptare gjen mishërimin e vet në figura të grave që shndërrohen në burra për të shpallur pavarësinë e tyre të fortë ndaj



kësaj shoqërie që edhe sot e kësaj dite kërkon të shndërrojë identitetin e saj të ëmbël në fortësi me fjalën "burrneshë" në Veri e "kapedane" në Jug.

Gra, që shfaqeshin përkrah burrave me kobure në brez edhe në kohë paqeje, pinin duhan e uleshin këmbëkryq në Kuvende (të drejta këto që nuk i gëzonte asnjë grua me burrë), duke hequr dorë përfundimisht nga të qenit grua. Gra-burra për nga forca dhe vrazhdësia, ndofta edhe më arrogante se edhe vetë burrat, si disa prej femrave të sotme në Kuvendin e Shqipërisë. Një lloj i shëmtuar njerëzor, i larguar nga e natyrshmja për shkak të instinktit të vetëmbrojtjes në këtë mjedis agresiv.

Kultura e të qenit femër në Shqipëri është ajo e një dhune psikologjike dhe sociale, që mjedisin e mbush me mlllef, nëse i duhet dikur të rebelojë (pasi ku mungon reforma nis revolucionin), nëse nuk pranon kuadrin e përgjithshëm në të cilin kjo shoqëri kërkon ta vendosë dhunshëm. Një rebelim i tillë është divorci.

Pasoja që sjell, përveç "vdekjes së vogël" të jetës së kaluar, shpesh për t'i dhënë fund një stresi të vazhdueshëm që pjell çrregullime psikologjike e në raste ekstreme edhe psikike, sjell edhe një jetë të konsideruar si të pasuksesshme në vazhdim, pra një diskriminim të ri social ndaj femrës. "E la burri të shkretën. Kush dreqin e di ç'i ka bërë qyqarit!"

Një tjetër tragjedi sociale nis. Një femër për t'u treguar me gisht, për t'u sulmuar prej të gjithë aventurierëve të një ndërgjegjeje të pashpirt. Një tjetër viktimitë-femër që duhet të

shndërrohet në burrë për të mbijetuar...

Kultura e të qenit femër në Shqipëri sot lidhet me një stereotip të ri njerëzor që duhet të kapërdijë hidhërimin e tradhtive të bashkëshortit bashkëkohor me "dinjitet". I duhet të mos ulërijë, pasi ky është mashkulli i suksesshëm për shqiptarin që ka nisur të mëkëmbet ekonomikisht përballë një femre, që nëse do ta tradhtonte të shoqin, shoqëria e "moralit" në Shqipëri do ta dënonte tmerrësisht ashpër, nën gjykimin "e drejtë" si të përdalë, të pamoralshme, të pandershme e gjithçka vulgare. Për të njëjtin mëkat qëndrimi social sigurisht që do të ishte edhe këtu diferencial. Burri, kjo qenie kaq e adhuruar prej vetvetes në jetën shqiptare do të quhej i zoti, ndërsa gruaja e ndyrë dhe e pështirë.

Shpesh qëndrimet mohuese e ndëshkuese ndaj femrës arrijnë deri në hakmarrje. Sa krime për "motive të dobëta" realizohen në Shqipëri për tradhtinë bashkëshortore! Madje nga burra që kanë tradhtuar kush e di sa herë gruan e tyre. Pa analizuar aspak arsytet dhe pasojat, shqiptari kalon përherë në ekstrem me "krenarinë" mashkullore dhe "fëlliqësinë" femërore. Sa marrëdhënie të dyfishta e shpesh të shumëfishta?!

Dukuri të reja sociale, ndofta edhe të vjetra, por tashmë tepër të shfaqura haptazi. Në gjithë këtë absurditet mentaliteti të ashpër, dënues e brutal vlen të përmendet koncepti i fljimitit femëror bazuar mbi konceptin nder dhe krenari në Shqipëri.

E ndershme për ndërgjegjen sociale është femra që nuk bën dashuri, krenar është mashkulli që ka një listë të gjatë femrash në triumfet e veta. Por, të dyja këto raste janë profile psikologjike të sëmura në jetën seksuale të njeriut, nëse mungesa e seksit është absolute për femrën dhe poligamia qëllim në vetvete për mashkullin.

Eja dhe shuaja shqiptarit absurd e agresiv tabunë sociale të seksit, pa ekuilibrimin shpirtëror. Eja dhe thuaj shqiptarit se koncepti i "burrneshës" apo "kapedanes" e shndërron femrën në mashkull e pasoja e parë dhe më e rrezikshmja është lindja dhe rritja e një mashkulli të pasigurt, frikacak e të dobët në shpirt që vishet me petkun e një agresori të dhunshëm social. Si t'i thërrmsh këto koncepte sociale të rrënjësura tashmë në ndërgjegje të sëmure?

Padyshim koncepti i gruas si një qenie sublime, e cila duhet respektuar me brishtësinë e saj, me bukurinë dhe mirësinë e saj, pasi është pikërisht ajo që i jep kuptimin e forcës dhe lumturinë një mashkulli, është pikërisht terapia sociale.

Shqiptari i sotëm ndodhet përballë një femre të lirë e të pavarur, e cila ka nisur të çlirohet prej mbetjeve patriarkale të së shkuarës. Kjo barazi e huton disi mashkullin shqiptar, i cili vjen prej një piedestali të rrënuar të një mbetjeve patriarkale të lodhur.

Dominuesi, i plotfuqishmi, kryelarti tashmë ndihet inferiori që nuk mund të vendosë pa pushtetin dhe dominimin, nuk mund të bashkëvendosë. Dhe këtu ai përdor dhunën fizike apo psikologjike. Gruaja, që sipas Kanunit në martesë kishte për detyrë: "me i rrejt nderën burrit, me i rrogu pa zhibla, me i ndejtë nën sundim, m'u përgjegj detyrve të kunorës, me rritë e me mkambë fmin me nderë, me i ndejtë gadi me të veshmen e të mathmen, mos me iu përzie në fejes të të bijve e bijave", sot është qenia sublime që i jep kuptim jetës së tij dhe kërkon respekt e vlerësim.

Martesa, që deri dje ishte "m'u ba shpi, me ia shtue shpisë një rob ma tepër, sa për kraht'punvet, sa për t'shtuem t'fmivet", sot është bashkë-udhëtimi i ëmbël dhe paqësor, cilësor dhe sublim, të paktën teorikisht për një marrëdhënie të shëndetshme. Nëse nuk është i tillë, nuk zgjat për gjithë jetën dhe detyrimisht është traumatik. Pa dyshim që janë tronditur themelet e tij të ekzistencës në këtë kohë të re dhe si në çdo tranzicion udhët janë të paqëndrueshme. Si adoleshent social mrekullohet e mahnetet me ndryshimet e femrës shqiptare, por përsëri luhetet në pasigurinë e gjetjes së vetvetes në të ardhmen.

T'ju them të drejtën, më dhimbset kjo qenie e brishtë që në dukje është kaq e ashpër, e egër dhe agresive që përpëlitet për të gjetur ekuilibrin shpesh me dhunë, shpesh me pendime...

Nuk është aspak e lehtë të tejkalohet vetvetja, por jo edhe e pamundur! Mjafton të jetë i duruar, i dhembshur, tolerant e mendje hapur. Të mos shohë si kërcënim për humbjen e pushtetit një femër që ka të drejtë të jetë përkrah tij me dinjitetin që i takon dhe jo me antagonizëm.

Gruaja nuk mund të jetë kurrë fatkeqësi e domosdoshme e realitetit tragjik. Ajo, e bukura, e mira, lozonjarja, e duruara, e dhembshura është bekim për shoqërinë.

Prej saj nis jeta, prej saj nis edhe një shoqëri më e mirë, sepse është ajo që ka në duar të ardhmen e fëmijëve të vet, e këta të fundit të ardhmen e këtij vendi duke pasur nevojën jetike për mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit.



**A**shtu si dritë dielli, erdhi Drita në familjen e saj, në Tiranë, më 16 dhjetor të vitit 1949. Vitet e para të fëmijërisë në ndryshim nga shumë moshatarë të saj, Drita Karoli (Prifti) do t'i kalonte jashtë vendit, në Bashkimin Sovjetik, ku babai i saj, i nderuari Mihal Prifti, kryente detyrën e ambasadorit shqiptar, ndërsa më pas dhe ambasador në Kinë. Në atdhe do të kthehej në klasën e pestë dhe fillimisht do të ndiqte shkollën ruse ku shkonin fëmijët e diplomatëve të huaj, kështu që gjuha bazë me të cilën do të shkollohej do të ishte rusishtja. Pas përfundimit të shërbimit diplomatik, familja e saj vendoset me banim në Shkodër.

Ishte vetëm 18 vjeçe, e sapo kishte përfunduar shkollën e mesme. Midis shumë mundësive u shfaq pikërisht edhe shkollimi në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Në fakt në qytetin ku jetonte kjo erdhi si një çudi. Askush nuk mund ta imagjinonte një vajzë të bukur si ajo, një vajzë e cila ndryshe nga të tjerat kishte pasur mundësi të njëjta edhe botën përtej Shqipërisë, të bëhej ushtarake. Kurse sa për prindërit, ata e konsideruar më se normale zgjedhjen që vajza e tyre bëri. Bashkë me të, nga qyteti i Shkodrës vendosën të vazhdonin shkollën ushtarake edhe dy vajza të tjera. E vetmja gjë që iu tha fillimisht në lidhje me shkollën, ishte fakti se, krahas programit të studimit ushtarak, do të kishin mundësi të ndiqnin edhe një program civil, që mund të ishte inxhinieri, financë etj. Pra i vetmi ndryshim që do të kishte nga shoqet e tjera do të ishte mbajtja e uniformës. Por kur mbërriti në oborrin e madh të Shkollës së Bashkuar, gjërat nuk ishin më kaq të thjeshta sa ishin dukur në fillim. I pari që e "pësoi" për shkak të disiplinës dhe rregullave ushtarake ishte gërsheti i bukur i Dritës. Në shkollën ushtarake nuk lejoheshin flokët e gjatë. Drita kujton momentin kur me nënën e saj, Sofien, u gjendën në një floktore në fillim të 'Rrugës së Dibrës' dhe gërshërët e mëdha që ia prenë pamëshirë gërshetin e trashë e të gjatë. Ky ishte privimi i parë i jetës së re prej ushtarakeje. Por në fakt ashtu si në këngën e njohur "Nënë moj do të pres gërshetin" vajza e imët, e druajtur, vendosi t'i hyjë një rruge të re, të panjohur, e bindur se do t'ia dilte. Në shtatorin e vitit 1967, Drita Karoli, nis studimet në shkollën ushtarake, në specialitetin e financës. Nuk u pendua për asnjë moment gjatë dy viteve shkollim për zgjedhjen e bërë. Madje, ashtu si ndodh natyrshëm në të gjitha mjediset studentore, ajo do të gjente aty edhe shokun e jetës, Kostaq Karolin, që në atë kohë ishte pedagog i taktikës në shkollë. Edhe ai ushtarak si ajo. Me Kostaqin u fejuua zyrtarisht në përfundim të vitit të parë dhe martesë do të vinte po kaq shpejt. Një martesë modeste pa shumë bujë. Të qenit të dy ushtarakë e bëri edhe më të fortë familjen tyre. Kur njëri mungonte, detyrat i merrte përsipër bashkëshorti tjetër. Edhe djemtë që iu erdhën në jetë, pavarësisht se nuk e ndoqën karrierën

# Nënkolonele Drita Prifti Karoli, zysha emblemë e urtësisë dhe mençurisë



emëronin mësuese në maturë. Ishte një klasë e mbushur plot me djem, të cilët edhe për shkak të zhvillimit moshor ishin shtatlartë e tepër të gjallë. Kërkoj të ndryshonte klasat me një koleg të saj dhe e nisi punën si mësuese e vitit të parë. Por kjo ndodhi vetëm në fillim, pasi për shumë vite me radhë ajo do të jepte mësim rregullisht në të gjitha klasat, në lëndët e saj të preferuara Histori, Filozofi, Ekonomi Politike etj. Nga koha e punës si pedagoge mbart mbresa të gjalla, pasi kanë qenë një numër i madh oficerësh që u ka dhënë mësim. Kujton se ata vinin nga shtresa të ndryshme shoqërore, me formime të ndryshme dhe detyra e tyre si pedagogë merrte një rëndësi të veçantë. Aq më tepër kur bëhej fjalë për një pedagoge ushtarake, pasi ajo ishte njëkohësisht pjesë e stafit pedagogjik, por edhe pjesë e komandës së shkollës. Për shkollën e mesme "Skënderbej", ajo ruan shumë nostalgji dhe e ka të vështirë të pranojë se ajo u mbyll për të mos u hapur

më. Kujton ditën kur u gjendën papritur, pa i lajmëruar askush përballë derve të mbyllura të saj. Bashkë me mbylljen e asaj porte, Drita mbylli edhe një karrierë të gjatë si edukatore, por që sot vjen përmes mirënjohjes së shumë ushtarakëve të karrierës, që për "zysh Dritën" flasin si për një perëndi urtësie e mençurie njëkohësisht. Ushtarakja e dy epokave, me ndryshimet e ndodhura në Shqipëri pas vitit 1992, ku ushtria do të ishte më e prekura, edhe Drita do të përballlej me dilemën nëse duhet ta vazhdonte karrierën e saj ushtarake.

E gjendur në krah të një bashkëshorti që gjithmonë ka qenë një ushtarak karriere deri në hierarkinë më të lartë ushtarake, atë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe me gradën gjeneralmajor, ajo asnjëherë nuk kërkoi të privilegjohej. Kështu që pranoi pa ngurrim të bëhej instruktore në Degën Ushtarake të qytetit të Tiranës, ku punoi deri në vitin 1996. Në vitin 1996 pasi u lirua nga ushtria me gradën "nënkolonel", ajo rifilloi punë si civile në Ministrinë e Mbrojtjes. Vitin e fundit të karrierës do ta mbyllte si shefe e personelit në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" e më pas pranë Komandës së Doktrinës dhe

ushtarake, që në fillim u mësuan me disiplinë dhe të qenit bashkëpunues.

Në përfundim të shkollimit ushtarak Drita, u emërua në Ministrinë e Mbrojtjes, në Drejtorinë e Ekonomisë.

